

Përshëndetje,

Duke ju referuar ankesës së pranuar, gjatë procedurës së qëndrimit të “Njoftim Publik”, ju informojmë se, me shkresën zyrtare “Informim”, me referencë 05 Nr. 070/01-9183/18 dt. 15.01.2019, të datës 29.01.2019

ankuesit janë informuar se kërkesa për caktim të kushteve ndërtimore, e referuar në ankesën e tyre, është në procedurë të shqyrtimit dhe vendosjes, dhe për vazhdimin e procedurës së mëtejme është kërkuar nga ankuesit që pranë kësaj drejtorie, të paraqesin kërkesë për ndërhyrje në procedurën administrative sipas kërkesës 05 Nr. 350/02–0286859/18 dt. 05.12.2018 për caktim të kushteve ndërtimore, për pjesën e parcelës kadastrale nr. 823-12 ZK Matiçan, dhe duke i bashkëngjitur projektin konceptual- zgjidhjen urbane të përbashkët dhe dëshminë për parcelën kadastrale në fjalë, dhe më pas kjo drejtori, duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 84 të Ligjit Nr. 05/L-03 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, do të bëjë bashkimin e dy çështjeve administrative në një procedurë të vetme, duke shqyrtuar zgjidhjen urbane të përbashkët, me trajtim në dy grupacione të ndara, me pëlqim të të gjithë bashkëpronarëve të asaj parcele kadastrale.

Më pas, kjo drejtori, nga ankuesit në fjalë ka pranuar kërkesën 05 Nr. 070/01-9183/19/1 dt. 12.02.2019, për ndërhyrje në procedurën administrative, sipas kërkesës 05 Nr. 350/02–0286859/18 dt. 05.12.2018 për caktim të kushteve ndërtimore, dhe të njëjtat janë në trajtim e sipër.

Me respekt,

Nazife Krasniqi

Zyrtare e Lartë për Planifikim dhe Zhvillim

Drejtorja e Urbanizmit

Komuna e Prishtinës

Tel: +383/44 200 528

E-mail: nazife.i.krasniqi@rks-gov.net